



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PROKURORI I PËRGJITHSHËM**

R R E G U L L O R E

**PËR
SISTEMIN E VLERËSIMIT TË PUNËS DHE TË AFTËSIVE
PROFESIONALE E MORALE TË PROKURORËVE**

Me synim, vlerësimin e punës dhe të aftësive profesionale e morale të prokurorëve, për efekt të qëndrueshmërisë në detyrë, ngritjes në karrierë apo caktimin në funksione drejtuese, etj, si dhe për të përmirësuar dhe zhvilluar punën personale dhe organizative, duke inkurajuar një nivel më të lartë të motivimit dhe pjesëmarrjes më gjerësisht të prokurorëve në ushtrimin e funksioneve të tyre;

Pasi u muarr mendimi i Këshillit të Prokurorisë;

Mbështetur, në nenin 42 të ligjit Nr. 8737 datë 12. 02. 2001 "Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, **caktoj Rregullat "Për Sistemin e Vlerësimit të Punës dhe Aftësive Profesionale dhe Morale të Prokurorëve", si më poshtë:**

**NENI 1
PËRKUFIZIME**

Në zbatim të kësaj Rregullore, termat e më poshtëm kanë këto kuptime:

1. **"Sistem i Vlerësimit të Punës dhe Aftësive Profesionale dhe Morale të Prokurorëve"**, SVPAPMP, është tërësia e kritereve dhe rregullave, për vlerësimin e punës, aftësive profesionale dhe morale të prokurorëve, në bazë të treguesve kryesore siç janë: - aftësia profesionale; - aftësia personale; - aftësia dhe qëndrimi shoqëror; - aftësia drejtuese/menaxhuse; - respektimi i disiplinës në punë; - masat disiplinore.
2. **"Aftësia profesionale"** përfshin grup treguesish kryesorë me elementë përbërës, siç janë: - aftësi të përgjithshme profesionale; - aftësia për të përballuar volum pune; - afati dhe shpejtësia e ndjekjes së çështjeve; - cilësia dhe profesionalizmi; - aftësia profesionale juridike dhe teknike;

- aftësia menaxhuese dhe zbatuese; - aftësia për angazhimin profesional.

3. **“Volumi/ngarkesa e punës”** është tregues i përafërt, provizor dhe i përgjithshëm, që përfaqëson numrin e procedimeve penale të ndjekura në hetimet paraprake, në gjykim ose në fazën e ekzekutimit dhe mbikëqyrjes së vendimeve penale të formës së prerë.

3.1 Standardi i krahasimi bëhet brenda çdo prokurorie, sipas niveleve dhe në shkallë vendi, për çdo prokuror dhe çdo vit. Devijimet që duhet të shënohen janë nëse luhatjet vjetore janë +/- 15% - 20% nga mesatarja për çdo funksion/emërtesë dhe/ose në shkallë vendi.

3.2 Në këtë tregues, duhet të merret parasysh veçanërisht kompleksiteti i procedimeve penale. Njëkohësisht, krahasimi i ngarkesës së punës ndërmjet prokurorëve duhet të bëhet bazuar:

3.2.1 në natyrën dhe llojet e njëjtë të treguesve të ndjekjes penale (homogjenitetin e punës);

3.2.2 orët e kaluara në gjyqe duhet të përmenden nëse numri (i lartë ose i ulët) i orëve nuk është i zakonshëm.

4. Në **“procedime penale komplekse”** përfshihen ato procedime penale, që veç lidhjes me masën e dënimit të parashikuar - për veprën penale të kryer - nga dispozita përkatëse në Kodin Penal, evidentohen edhe faktorë të tillë siç mund të jenë:

4.1 Rëndësia, vështirësia ligjore e faktike dhe objekti i çështjes penale, (krimi i organizuar dhe ekonomik, korrupsioni, trafikimet e paligjshme, vrasjet e cilësuar, etj);

4.2 Numri i të pandehurve ose të arrestuarve, procedime të lidhura në disa rrethe gjyqësore dhe/ose që ndiqen në bashkëpunim juridiksional me autoritete të huaja gjyqësore, si dhe faktorë të tjerë të ngjashëm, tregues këto të hetimeve apo procedimeve me shtrirje të gjërë;

4.3 Procedime/çështje të rëndësishme mund të influencojnë vlerësimin. Rëndësia e tyre përcaktohet nga arsye serioze, politike, ekonomike ose shoqërore, të një interesi publik të lartë dhe specifik.

5. **“Cilësia dhe profesionalizmi”** në sistemin e vlerësimit përfshijnë elementët thelbësorë, siç janë: - kualifikimet profesionale, cilësia e punës së kryer e lidhur me qëndrueshmërinë në situata të diskutueshme, në zgjidhjet ligjore përfundimtare të procedimeve në fazën e hetimeve paraprake, ngritjen e akuzës në gjykatë dhe ekzekutimin e vendimeve penale; - aftësi profesionale të përgjithshme, kryerja e volumit të punës, (përbërja dhe trajtimi i procedimeve, plotshmëria, kuptueshmëria, aftësia për të hartuar/formuluar kërkesa/aktë proceduriale të qarta dhe me tekst të kujdesshëm, aftësia për të argumentuar, bindur etj, aftësitë negociuese dhe pyetëse),

përfshi përgatitjen teknike dhe eksperiencat e trajnimit; - aftësia për të drejtuar me efektivitet hetimet, ndjekjen penale dhe për të siguruar një bashkëpunim efektiv me policinë gjyqësore; - aftësia që ka prokurori, për të organizuar, drejtuar dhe kontrolluar punën e policisë gjyqësore, si dhe për të organizuar sa më me efektivitet burimet materiale dhe njerëzore; - aftësia e angazhimit profesional; aftësia për të shkruar punime juridike.

6. **“Afatet dhe shpejtësia”** është respektimi i afateve të arsyeshme, ligjore dhe atyre të motivuara, të hetimeve paraprake, arrestimit në flagrancë, ndalimit dhe paraburgimit, deri në zgjidhjen ligjore të çështjes dhe ekzekutimit të vendimeve gjyqësore penale.
7. **“Aftësia personale”** përfshin grup treguesish kryesorë me element përbërës, siç janë: - vlerësime të përgjithshme mbi personalitetin e prokurorit; - ndërgjegjësimi, ndjenja e detyrës dhe përgjegjësisë; - aftësia për të punuar nën presion, gatishmëria për të ndihmuar dhe marrë përgjegjësi; - vetëmenaxhimi, aftësia për të organizuar; - vullneti për të vendosur dhe vendimi në kohën e duhur; - vullneti për të qenë novator dhe i zhdërvjellët; - besnikëria.
8. **“Aftësia dhe qëndrimi shoqëror”** përfshin grup treguesish kryesorë me element përbërës, siç janë: - aftësia për të punuar në ekip; - aftësia për të komunikuar; - aftësia për të diskutuar dhe ndërmjetësuar.
9. **“Aftësia drejtuese/menaxhuese”** përfshin grup treguesish kryesorë me element përbërës, siç janë: - aftësia për të organizuar, menaxhuar dhe kontrolluar hetimin me efektivitet; - aftësia për të menaxhuar detyrimet dhe detyrat dytësore; - aftësia për të krijuar atmosferë të mirë pune; - aftësia për të krijuar marrëdhënie të mira me vartësit; - aftësia për ushtrimin e funksionit të mbikëqyrjes në një mënyrë të përgjegjshme dhe të komunikueshme;
10. **“Respektimi i disiplinës në punë”** është përmbushja me korrektësi e disiplinës dhe të gjitha angazhimeve profesionale, personale, morale dhe etike në ushtrimin e funksioneve në zbatim të Kushtetutës dhe ligjeve, duke ruajtur të pastër figurën e prokurorit.
11. **“Masa disiplinore”** janë penalitete vërejtje, vërejtje me paralajmërim për shkarkim nga detyra dhe pezullim nga detyra ose kalimi në një detyrë tjetër më të ulët, që janë në fuqi në kohën e vlerësimit të punës, neni 33 i ligjit “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në R. Sh”.

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

NENI 2

QËLLIMI I SISTEMIT TË VLERËSIMIT

1. Qëllimi i sistemit të vlerësimit të punës dhe të aftësive profesionale dhe morale të prokurorëve synon:
 - 1.1. realizimin e një procesi për rritjen e përgjegjësisë së prokurorëve në ushtrimin e funksioneve në; ndjekjen penale, ngritjen dhe përfaqësimin e akuzës në gjykatë dhe ekzekutimin e vendimeve penale, duke bazuar lidhjen e punës individuale më atë të niveleve drejtuese sipas shkallës së hierarkisë në prokurori.
 - 1.2. realizimin e procesit për të ndjekur karrierën dhe përzgjedhur në mënyrë të drejtë dhe transparente kandidatët:
 - 1.2.1. për efekt të ngritjes në detyrë si prokuror apeli ose prokuror në Prokurorinë e Përgjithshëm;
 - 1.2.2. për caktimin e prokurorëve në funksione drejtuese të Prokurorëve;
 - 1.2.3. për të shpërblyer prokurorët që kanë merita profesionale dhe tregues efektiv në ushtrimin e funksioneve.
 - 1.3. promovimin e qëndrueshmërisë në detyrë të prokurorëve dhe për marrjen e masave disiplinore ndaj atyre që vlerësohen të paaftë;
 - 1.4. për të identifikuar boshlleqet ose mangësit profesionale dhe nevojat për trajnimin e prokurorëve.

NENI 3

KOHA, MËNYRA DHE FORMA E VLERËSIMIT

1. Vlerësimi i punës dhe aftësive profesionale dhe morale të prokurorëve, duhet të kryhet:
 - 1.1 pas intervaleve të rregullta kohore gjer në tre vjetë, përveç prokurorëve të Prokurorisë së Përgjithshme;
 - 1.2 për prokurorët që kërkojnë ngritje në detyrë, transferim apo kandidojnë për drejtues prokurorie;
 - 1.3 për çdo prokuror të porsa emëruar, gjashtë muajsh ose një vit, duke filluar nga data e fillimit të punës së tij;
 - 1.4 nëse një prokuror vlerësohet “mjaftueshëm”, brenda një viti bëhet rivlerësimi i tij.
2. Vlerësimi i punës së prokurorit do të kryhet në mënyrë të alternuar, duke vlerësuar të gjithë elementët e procesit të punës së tij.
3. Vlerësimi përgatitet në formë përshkruese dhe statistikore edhe nga Drejtoria e Inspektimit dhe e Burimeve Njerëzore, mbi bazën e të dhënave të inspektimit të kryer nga kjo drejtori dhe mbështetur në informacionet vetvlerësuese dhe të vlerësimit paraprak të marra nga prokurori dhe drejtuesi i prokurorisë ku ai ushtron funksionin.
4. Ky vlerësim shqyrtohet nga Këshilli i Prokurorisë, i cili mendimin e vet ia paraqet Prokurorit të Përgjithshëm.

KREU II KRITERET E VLERËSIMIT

NENI 4 KRITERET E VLERËSIMIT TË PROKURORËVE

1. Vlerësimi i punës dhe i aftësive profesionale e morale të prokurorëve do të kryhet sipas kriterëve të grupeve kryesore, si më poshtë:

- .1 Aftësitë profesionale;** *(seksioni I)*
- .2 Aftësitë personale;** *(seksioni II)*
- .3 Aftësitë dhe qëndrimi shoqëror;** *(seksioni III)*
- .4 Aftësitë administruese/menaxhuese;** *(seksioni IV)*
- .5 Respektimi i disiplinës në punë;** *(seksioni V)*
- .6 Masat disiplinore në fuqi në kohën e vlerësimit.** *(seksioni VI)*

SEKSIONI I KRITERE TË VLERËSIMIT TË AFTËSISË PROFESIONALE

NENI 5 KRITERE TË AFTËSIVE PROFESIONALE

1. Në kriteret e aftësive profesionale, përfshihen grupime të treguesve kryesorë me elementët përbërës, si më poshtë:

- 1.1 Kriteret e aftësive të përgjithshme profesionale.
- 1.2 Kriteret e vlerësimit të volumit të punës.
- 1.3 Kriteret e vlerësimit të shpejtësisë.
- 1.4 Kriteret e cilësisë dhe profesionalizmit.
- 1.5 Kriteret e aftësive menaxhuese dhe zbatuese.
- 1.6 Kriteret e vlerësimit të publikimeve juridike.

SEKSIONI I/1 KRITERE TË AFTËSIVE TË PËRGJITHSHME PROFESIONALE

NENI 6 AFTËSITË E PËRGJITHSHME PROFESIONALE

1. Në kriteret e aftësive të përgjithshme profesionale të prokurorit, përfshihen:

- 1.1 Aftësia për të vendosur, argumentuar dhe mbështetur aktet procedurale;
- 1.2 Aftësia për të dëgjuar dhe komunikuar;
- 1.3 Aftësia për t'u përshtatur.

NENI 7 AFTËSIA PËR TË VENDOSUR, ARGUMENTUAR DHE MBËSHTETUR AKTET PROCEDURALE

1. Me aftësi për të vendosur, argumentuar dhe mbështetur aktet procedurale vlerësohen:
 - 1.1 aftësia e prokurorit për të kryer ndjekje penale të rasteve që i janë caktuar në të gjitha fazat, brenda një afati ligjor dhe të arsyeshëm;
 - 1.2 arsyet e përdorura për të argumentuar dhe mbështetur aktet procedurale ose diskutimet përfundimtare, me të cilat prokurori argumenton dhe mbron kërkesat e tij gjatë seancave gjyqësore.

NENI 8

AFTËSIA PËR TË DËGJUAR DHE KOMUNIKUAR

Me aftësi për të dëgjuar dhe komunikuar vlerësohet aftësia e prokurorit për të trajtuar me respekt të gjithë subjektet e procedimit penal dhe në vecanti gjykatën, drejtuesit e prokurorisë, kolegët dhe personelin administrativë.

NENI 9

AFTËSIA PËR TU PËRSHTATUR

1. Me aftësi për tu përshtatur vlerësohet aftësia e prokurorit:
 - 1.1. për t'u përshtatur me vendin e punës dhe ndryshimet e tij, ndryshimet strukturore të prokurorisë, ku ai ushtron funksionin,
 - 1.2. për t'u azhornuar me ndryshimet ligjore, vendimet unifikuese të Gjykatës së Lartë dhe aktet normative të Prokurorit të Përgjithshëm, me teknikat dhe mjetet e reja të hetimit, si dhe;
 - 1.3. për t'u përshtatur me situatat e paparashikuara në ushtrimin e funksioneve të tij.

SEKSIONI I/2

KRITERE TË VLERËSIMIT TË VOLUMIT TË PUNËS

NENI 10

VLERËSIMI I VËLLIMIT TË PUNËS

1. Prokurori vlerësohet për vëllimin e punës të kryer, sipas fazave të ndjekjes penale, në hetimet paraprake, në gjykim ose në fazën e ekzekutimit të vendimeve penale të formës së prerë dhe mbikëqyrjes së vuajtjes së dënimit.
2. Në këtë kriter vlerësimi, në konsideratë të veçantë merret kompleksiteti i procedimeve penale në hetimet paraprake dhe në ngritjen e akuzës në gjykatë.
3. Krahasimi i vëllimit të punës ndërmjet prokurorëve bëhet bazuar në natyrën dhe llojet e njëjta të treguesve të ndjekjes penale dhe ngritjes së akuzës në gjykatë.

SEKSIONI I/3

KRITERE TË VLERËSIMIT TË SHPEJTËSISË

NENI 11
VLERËSIMI I SHPEJTËSISË

Prokurori vlerësohet për shpejtësinë në ushtrimin e ndjekjes penale, mbështetur në respektimin e afateve të arsyeshme, ligjore dhe afateve të motivuara, të hetimeve paraprake ose paraburgimit, për të cilat mund të merret zgjatje, deri në zgjidhjen ligjore përfundimtare të çështjes, si dhe respektimi i afateve të ekzekutimit të vendimeve penale.

SEKSIONI I/4
KRITERE TË VLERËSIMIT TË CILËSISË DHE PROFESIONALIZMIT

NENI 12
GRUPI I KRITERE TË CILËSISË DHE PROFESIONALIZMIT

1. Në grupin e kriterëve të cilësisë dhe profesionalizmit, përfshihen elementët përbërës, si më poshtë:
 - 1.1. Cilësia në zgjidhjet ligjore përfundimtare të ndjekjes penale në hetim dhe ngritjen e akuzës në gjykatë, si dhe në ekzekutimin e vendimeve penale;
 - 1.2. Aftësitë profesionale juridike dhe teknike, për të drejtuar me efektivitet hetimet dhe për të siguruar një bashkëpunim efektiv me policinë gjyqësore;
 - 1.3. Aftësitë e angazhimit profesional.

SEKSIONI I/4-1
KRITERE TË CILËSISË NË ZGJIDHJET LIGJORE

NENI 13
CILËSIA NË ZGJIDHJET LIGJORE

1. Cilësia në zgjidhjet ligjore në veprimtarinë e prokurorit vlerësohet bazuar në ligjshmërinë e akuzave të ngritura dhe në ligjshmërinë e zgjidhjeve përfundimtare të çështjeve në hetimet paraprake, në gjykim dhe në ekzekutimin e vendimeve gjyqësore penale të formës së prerë, sipas klasifikimit.
 - 1.1 Zgjidhje ligjore cilësore;
 - 1.2 Zgjidhje ligjore jociësore;
 - 1.3 Zgjidhje e gabuar ligjore;

NENI 14
ZGJIDHJE LIGJORE CILËSORE

1. Zgjidhje ligjore cilësore konsiderohen rastet kur:
 - 1.1 Vendimet e mosfillimit, vendimet përfundimtare në hetimet paraprake për pushimin e çështjeve apo akuzave ose për

- pezullimin e hetimeve vlerësohen të bazuara në ligj nga gjykata ose nga prokurori më i lartë;
- 1.2 akuzat e ngritura nga prokurori, në Gjykatën e shkallës së parë ose të apelit janë pranuar nga gjykata përkatëse dhe vendimi ka marrë formë të prerë;
 - 1.3 Gjykata e shkallës së parë nuk ka pranuar kërkesat e prokurorit në diskutimin përfundimtarë dhe mbi apelimin e tij, Gjykata e Apelit ka pranuar apelimin;
 - 1.4 Gjykata e shkallës së parë nuk ka pranuar kërkesat e prokurorit, Gjykata e Apelit nuk ka pranuar apelimin e tij dhe Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka pranuar rekursin e prokurorit kundër dy vendimeve të gjykatave të shkallëve më të ulta.
 - 1.5 mbi rekursin e prokurorit të apelit, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka pranuar rekursin, kundër vendimit të Gjykatës së Apelit, të dhënë në kundërshtim me kërkesat e tyre;

NENI 15

ZGJIDHJE LIGJORE JOCILËSORE

Zgjidhje ligjore jocilësore konsiderohen rastet kur kërkesat e prokurorit pranë gjykatës së faktit janë pranuar pjesërisht nga gjykata, për kualifikim ligjor të gabuar të veprës penale, për caktim të gabuar të llojit dhe masës së dënimit për një ose disa të pandehur në procedimet me shumë të pandehur dhe vendimi merr formë të prerë pa u ankimuar, si dhe kur kërkesat e prokurorit të apelit, që mbështesin apelimin e prokurorit më të ulët, pranohen pjesërishtë nga gjykata dhe për pjesën tjetër kthehen për rigjykim dhe vendimi mbetet në fuqi.

NENI 16

ZGJIDHJE TË GABUARA LIGJORE

1. Zgjidhje të gabuara ligjore konsiderohen, rastet kur:
 - 1.1 Kërkesa e prokurorit në diskutim përfundimtarë, nuk pranohen nga gjykata, që vendosë pafajsi ose pushim çështje/akuze dhe vendimi mbeten në fuqi edhe nga gjykatat e shkallëve më të larta;
 - 1.2 Kërkesa e prokurorit në diskutim përfundimtarë është në kundërshtim me ligjin dhe provat, dhe i paraprin vendimit gjyqësor të pafajësisë, pushimit të çështjeve/akuzave dhe kthimit të akteve prokurorit.
 - 1.3 Vendimi i pushimit të çështjeve ose vendimi i mosfillimit të procedimit është prishur nga gjykata ose është shfuqizuar nga prokurori më i lartë dhe për këto çështje është ngritur akuzë në gjykatë, e cila ka deklaruar fajësinë e personave të akuzuar.

KRITERE TË AFTËSIVE PROFESIONALE JURIDIKE DHE TEKNIKE

NENI 17

AFTËSITË PROFESIONALE JURIDIKE DHE TEKNIKE

1. Në aftësitë profesionale juridike dhe teknike të prokurorit, për të drejtuar me efektivitet ndjekjen penale dhe për të siguruar një bashkëpunim efektiv me policinë gjyqësore vecanërisht në fazën e hetimeve paraprake, përfshihen:
 - 1.1 Aftësia për të përdorur njohuritë juridike;
 - 1.2 Aftësia në drejtimin dhe kontrollin e policisë gjyqësore;
 - 1.3 Aftësia për të kryer ndjekje penale në hetim dhe në gjyq dhe për të krijuar dhe administruar procedimin penal;
 - 1.4 Aftësia për pjesëmarrje dhe aktivizim në aktivitete profesionale.

NENI 18

AFTËSIA PËR TË PËRDORUR NJOHURITË JURIDIKE

Me aftësi për të përdorur njohuritë juridike vlerësohet aftësia e prokurorit për të përcaktuar saktë versionet dhe objektin e ndjekjes penale në hetim dhe gjykim, rrethanat dhe faktet që janë të nevojshme për tu administruar, mjetet që duhen përdorur për kerkimin dhe marrjen e provave, si dhe ndikimin e tyre për zgjedhjen e mënyrës së përfundimit të hetimeve ose ngritjen dhe përfaqësimin e akuzës në përputhje me ligjin.

NENI 19

AFTËSIA NË DREJTIMIN DHE KONTROLLIN E POLICISË GJYQËSORE

Me aftësi për drejtimin dhe kontrollin e policisë gjyqësore vlerësohet aftësia e prokurorit për të drejtuar, ndihmuar dhe kontrolluar veprimtarinë e oficerit apo agentit të policisë gjyqësore të ngarkuar prej tij për kryerjen e veprimeve hetimeve paraprake ose veprimeve të tjera procedurale, për të realizuar një procedim penal efektiv dhe për të garantuar të drejtat dhe liritë e shtetasve.

NENI 20

AFTËSIA PËR TË KRYER NDJEKJE PENALE, NGRITJE TË AKUZËS NË GJYKATË, DHE ADMINISTRUAR PROCEDIMET PENALE

1. Me aftësi për të kryer ndjekje penale, ngritje të akuzes në gjykatë dhe administruar një procedim penal vlerësohet aftësia e prokurorit:
 - 1.1 për të organizuar dhe ndjekur procedimin penal që në momentin e marrjes së një kallëzimi penal apo referimi të veprës penale nga policia gjyqësore, deri në zgjidhjen ligjore përfundimtare të procedimit penal;
 - 1.2 për të njohur në detaje pikat e forta dhe të dobta të akuzës së ngritur në gjykatë dhe për të qënë aktiv dhe ndërhyrë në momentet e duhura gjatë debatit në shqyrtim gjyqësor, duke u

- shprehur qartë dhe në përputhje me rregullat që parashikon ligji dhe etika prokurorit;
- 1.3 për të evituar çdo sjellje jo etike dhe manifestuar paragjykime kundër palëve në proces penal, si dhe për të evituar polemikat e panevojshme teknike me kolegët dhe gjyqtarët;
 - 1.4 për të administruar procedimin penal në hetimet paraprake dhe në gjykim me aktet e nevojshme, të strukturuar qartë, për të qenë sa më të shfrytëzyeshëm

NENI 21

AFTËSIA NË PJESËMARRJE DHE AKTIVIZIM NË AKTIVITETE PROFESIONALE

Me aftësi për pjesmarrje dhe aktivizim në aktivitete profesionale vlerësohet aftësia e prokurorit për të marrë pjesë aktive në aktivitetet profesionale që kryhen me prokurorë, oficerë dhe agjentë të policisë gjyqësore apo dhe me subjekte të tjerë të procedimit penal, duke identifikuar drejt problematikën dhe duke trajtuar atë në mënyrë të efektshme.

SEKSIONI I/4-3

KRITERE TË AFTËSIVE PËR ANGAZHIMIN PROFESIONAL

NENI 22

ANGAZHIMI PROFESIONAL

1. Me aftësi për angazhimin profesional vlerësohen aftësitë e prokurorit për tu angazhuar profesionalisht në aspekte të mëtejshme të punës së tij, ku përfshihen:

- 1.1 Aftësia e prokurorit për të qenë efektiv në ushtrimin e ndjekjes penale, ngritjen e akuzës në gjykatë dhe ekzekutimin e vendimeve penale;
- 1.2 Aftësia e tij për zbatimin dhe përsosjen e dijeve, për të ndërmarrë nisma ose veprime, për aktualizimin dhe përsosjen e dijeve dhe metodave bashkëkohore të ndjekjes penale, për identifikimin e nevojave për një formim të mëtejshëm profesional;
- 1.3 Aftësia e prokurorit për të ndërtuar marrëdhëniet profesionale me institucionet e tjera, sipas funksioneve dhe kompetencave të tij.

SEKSIONI I/5

KRITERE TË AFTËSIVE MENAXHUESE DHE ZBATUESE

NENI 23

AFTËSITË MENAXHUESE DHE ZBATUESE

1. Me aftësi menaxhuese apo administrative dhe zbatuese vlerësohet aftësia e prokurorit për të organizuar sa më me efektivitet burimet

njerëzore dhe materjale, si dhe aspekte të tjera ekzekutive të procesit të punës së tij, ku përfshihen:

- 1.1 Aftësia për të organizuar kryerjen e veprimeve të nevojshme procedurale apo administrative të procedimeve penale, në prokurori dhe me policinë gjyqësore, duke planifikuar qartë veprimet që do të kryhen dhe burimet e nevojshme njerëzore dhe materiale;
- 1.2 Aftësia për të kordinuar punën e tij me personelin administrativ, duke i bërë ata të ndërgjegjshëm për nevojat që duhen plotësuar për procedimet në ndjekje penale prej tij;
- 1.3 Aftësia për t'i zbatuar veprimet e planifikuara në mënyrë efektive.

SEKSIONI I/6

KRITERE TË VLERËSIMIT TË PUBLIKIMEVE JURIDIKE

NENI 24

VLERËSIMI I PUBLIKIMEVE JURIDIKE

Prokurori vlerësohet për botim të punimeve juridike, si shkrime apo libra, në fushën e së drejtës, të botuara brenda dhe jashtë vendit, gjatë periudhës që bëhet vlerësimi i punës, bazuar në cilësinë, rëndësinë dhe vlerat shkencore të tyre.

SEKSIONI II

KRITERE TË VLERËSIMIT TË AFTËSIVE PERSONALE

NENI 25

KRITERE TË AFTËSIVE PERSONALE

1. Në kriteret e aftësive personale, përfshihen grup treguesit kryesorë me elementët përbërës, si më poshtë:

- 1.1 Vlerësime të përgjithshme mbi personalitetin e prokurorit;
- 1.2 Ndërgjegjësimi, ndjenja e detyrës dhe përgjegjësisë;
- 1.3 Aftësia për të punuar nën presion, gatishmëria për të ndihmuar dhe marrë përgjegjësi;
- 1.4 Vetë-menaxhimi, aftësia për të organizuar;
- 1.5 Vullneti për të vendosur dhe vendimi në kohën e duhur;
- 1.6 Vullneti për të qenë novator dhe i zhdërvjellët;
- 1.7 Besnikëria.

NENI 26

VLERËSIME TË PËRGJITHSHME

1. Në vlerësime të përgjithshme mbi personalitetin e prokurorit, përfshihen:

- 1.1 Krahas nivelit arsimor dhe kualifikues profesional, vlerëso dhe nivelin e përgjithshëm kulturor dhe gjithanshmërinë e tij;

- 1.2 Demonstrim i sjelljes dinjitoze, të prerë dhe të mirë, qetësia dhe kompetenca;
- 1.3 Mbajtja e ekuilibrit, ftohtësia dhe gjakftohtësia;
- 1.4 Pranimi/angazhimi për t'u përballur me detyra të vështira;
- 1.5 Njohja e pikave të forta, fuqisë dhe mangësive dhe qenia në gjendje për korrigjimin dhe përmirësimin e tyre.

NENI 27

NDËRGJEGJËSIMI, NDJENJA E DETYRËS DHE E PËRGJEGJËSISË

1. Në cilësitë ndërgjegjësimit, ndjenjë të detyrës dhe të përgjegjësisë së prokurorit, përfshihen:
 - 1.1 Ndërgjegjësimi për përgjegjësinë e tij dhe të qenit shembull;
 - 1.2 Kryerja e detyrave me kujdes dhe si duhet;
 - 1.3 Angazhimi i burimeve të mjaftueshme personale dhe materiale;
 - 1.4 Kujdesi për çështjet e brendshme dhe organizative;
 - 1.5 Trajtimi i të gjitha çështjeve, përfshi dhe i një volumi të madh pune në mënyrë të përgjegjshme;

NENI 28

AFTËSIA PËR TË PUNUAR NËN PRESION

1. Me aftësi për të punuar nën presion dhe gatishmëri për të ndihmuar dhe marrë përgjegjësi, përfshihen:
 - 1.1 Aftësia mendore dhe fizike për të punuar nën presion, njohja e limiteve të veta;
 - 1.2 Vullneti për të marrë përsipër punë shtesë;
 - 1.3 Puna edhe në situata stresi dhe presioni për një punë cilësore dhe në mënyrë të përqendruar;
 - 1.4 Mbajtja e standardeve cilësore edhe në rastet e volumit të lartë të punës;
 - 1.5 Qetësia, durimi i presionit dhe marrja e iniciativave;
 - 1.6 Demonstrimi i bashkëpunimit dhe vullnetit për të ndihmuar.

NENI 29

AFTËSIA PËR TË ORGANIZUAR

1. Në cilësitë vetëmenaxhuese dhe aftësinë për të organizuar, përfshihen:
 - 1.1 Planifikimi i punës, caktimi i afateve kohore dhe prioritetëve;
 - 1.2 Kryerja e punës me vetëpërmbytje dhe me objektiva të orientuara drejtë;
 - 1.3 Formulimi me efektivitet i pasojave të punës dhe realizimi i planit të punës së tij hap pas hapi;
 - 1.4 Motivimi i vetes dhe të tjerëve;
 - 1.5 Delegimi i detyrës, duke marrë parasysh planet e punës dhe rrjedhën e punës, si dhe nevojat dhe problemet e tjera të personave të përfshirë;
 - 1.6 Kryerja e veprimeve në një mënyrë ekonomike sipas çështjes.

NENI 30
VULLNETI PËR TË VENDOSUR NË KOHËN E DUHUR

1. Në vullnet për të vendosur dhe marrja e vendimit në kohën e duhur, përfshihen:

- 1.1 Realizimi dhe njohja e kohës dhe mundësisë më të mirë për të vendosur;
- 1.2 Vendimi i shpejtë dhe me vetë-përgjegjësi duke mos patur frikë nga trajtimi i objektit të vendimit të tij;

NENI 31
VULLNETI PËR TË QENË NOVATOR DHE I ZHDËRVJELLËT

1. Në vullnet për të qenë novator dhe i zhdërvjellët, përfshihen:

- 1.1 Qenia i hapur kundrejt teknikave dhe metodave të reja të punës dhe reformimit e modernizimit të prokurorisë dhe gjyqësorit;
- 1.2 Zhvillimi i ideve të reja, zgjidhjeve, marrja e sugjerimeve të reja dhe të mësuarit nga eksperiencia e punës;
- 1.3 Reagimi i duhur në situata të ndryshme;
- 1.4 Gatishmëria për të punuar dhe bashkëpunuar me një zyrë, agjensi apo struktura të ndryshme.

NENI 32
BESNIKËRIA

1. Në besnikëri, përfshihen:

- 1.1 Ndjekja e udhëzimeve të dhëna besnikërisht dhe me vendosmëri;
- 1.2 Informimi i eprorëve me korrektesë në lidhje me çështjet e rëndësishme dhe për interesat në çështjet zyrtare përkatëse;
- 1.3 Pranimi i këshillave, konsideratave dhe udhëzimeve.

SEKSIONI III
KRITERE TË VLERËSIMIT TË AFTËSIVE DHE QËNDRIMIT SHOQËROR

NENI 33
KRITERE TË AFTËSISË DHE QËNDRIMIT SHOQËROR

1. Në kriteret e aftësive dhe qëndrimit shoqëror, përfshihen grup treguesit kryesorë me elementët përbërës, si më poshtë:

- 1.1 Aftësia për të punuar në ekip;
- 1.2 Aftësia për të komunikuar;
- 1.3 Aftësia për të diskutuar dhe ndërmjetësuar;

NENI 34
AFTËSIA PËR TË PUNUAR NË EKIP

1. Në aftësinë për të punuar në ekip, përfshihen elementët përbërës:
 - 1.1 Ndarja e eksperiencës, njohurive, zgjidhjeve të mundshme dhe informacionit;
 - 1.2 Forcimi i ndjenjës së kolektivitetit dhe shpirtit të ekipit;
 - 1.3 Adoptimi me ekipin ose grupin e punës dhe dhënia ndihmë të tjerëve për ta bërë këtë;
 - 1.4 Nxitja e veprimeve të përbashkëta dhe zgjidhjeve të shëndosha;
 - 1.5 Kërkimi i dialogut dhe diskutimit dhe veprimi si person kontakti;

NENI 35

AFTËSIA PËR TË KOMUNIKUAR

1. Në aftësinë për të komunikuar, përfshihen elementët përbërës:
 - 1.1 Dëgjimi në mënyrë aktive dhe komunikimi me respekt me gjithë personat e përfshirë;
 - 1.2 Përshtatja me zgjidhjet e duhuara, të ndryshme nga ato të propozuara vetë, ndryshimet/reagimet e duhuara në situatat e papritura;
 - 1.3 Inicimi i kontaktit me të tjerët;
 - 1.4 Qartësia, shprehja në mënyrë të thjeshtë, argumentimi me objektivitet dhe përmbajtja në fakte, si dhe kërkesa ndaj të tjerëve për objektivitet;
 - 1.5 Marrja e vendimeve transparente;
 - 1.6 Inkurajimi dhe ndihma për shkëmbimin e eksperiencës me kolegët e zyrës;
 - 1.7 Mbajtja parasysht e interesave të kundërta dhe problemeve të dëshmitarëve;
 - 1.8 Qetësia, afrueshmëria dhe mirësjellja;
 - 1.9 Respektimi i marrëveshjeve, marrëveshjet gojore;
 - 1.10 Ndihma/harxhimi i kohës nëse kërkohet nga të tjerët;

NENI 36

AFTËSIA PËR TË DIKUTUAR DHE NDËRMJETËSUAR

1. Në aftësitë për të diskutuar dhe ndërmjetësuar, përfshihen elementët përbërës:
 - 1.1 Aftësia dhe vullneti për të bërë kompromis në interes të zgjidhjeve të drejta dhe ligjore;
 - 1.2 Marrja në konsiderat e argumenteve të të tjerëve;
 - 1.3 Sjellja me integritet, drejtësia dhe sjellja si koleg i mirë, demonstrimi i solidaritetit;
 - 1.4 Diskutimi dhe kritika në mënyrë konstruktive;
 - 1.5 Qenia balancues dhe kërkimi i mirëkuptimit;
 - 1.6 Qëndrime dhe referenca në pozicione të qarta.

SEKSIONI IV
KRITERE TË VLERËSIMIT TË AFTËSIVE DREJTUESE

NENI 37
KRITERE TË AFTËSIVE DREJTUESE

1. Në kriteret e aftësive drejtuese, përfshihen grup treguesit kryesorë me elementët përbërës, si më poshtë:
 - 1.1 Aftësia për të organizuar, menaxhuar dhe kontrolluar hetimin me efektivitet;
 - 1.2 Aftësia për të menaxhuar detyrimet dhe detyrat dytësore;
 - 1.3 Aftësia për të krijuar atmosferë të mirë pune;
 - 1.4 Aftësia për të krijuar marrëdhënie të mira me vartësit;
 - 1.5 Aftësia për ushtrimin e funksionit të mbikëqyrjes në një mënyrë të përgjegjshme dhe të komunikueshme;
 - 1.6 Veçantësitë e punës mbikëqyrëse;

NENI 38
AFTËSIA PËR TË ORGANIZUAR, MENAXHUAR DHE KONTROLLUAR HETIMET ME EFektivITET

1. Në kriteret e aftësive për të organizuar, menaxhuar dhe kontrolluar hetimin me efektivitet, përfshihen elementët përbërës:
 - 1.1 Caktimi i detyrave në mënyrë të përshtatshme; lëshimi i udhëzimeve të qarta;
 - 1.2 Sigurimi i bashkëpunimit të efektshëm me Policinë Gjyqësore;
 - 1.3 Asistimi i aktivitetit të Policisë Gjyqësore ose një oficeri/agjenti tjetër të organeve hetimore;
 - 1.4 Organizimi me efektivitet i burimeve materiale dhe njerëzore të prokurorisë apo strukturës që drejton;
 - 1.5 Bashkërendimi i punës së tij me kancelarin aty ku ka dhe/ose me kryesekretare;
 - 1.6 Diskutimi i të gjitha çështjeve të dinamikës së punës;

NENI 39
AFTËSIA PËR TË MENAXHUAR DETYRIMET DYTËSORE

1. Në kriteret e aftësive për të menaxhuar detyrimet dytësore, përfshihen elementët përbërës:
 - 1.1 Planifikimi i punës në mënyrë të tillë që të mënjanohet transferimi i panevojshëm i dosjeve;
 - 1.2 Kontrolli i punës me çështjet mbi bazën e raporteve dhe regjistrave që tregojnë afatet e procedimeve penale, caktimi i çështjeve, çështjet e kthyera dhe ngarkesa e çështjeve për prokurorët dhe për oficerët e policisë gjyqësore.

NENI 40
AFTËSIA PËR TË KRIJUAR ATMOSFERË TË MIRË NË PUNË

1. Në kriteret e aftësive për të krijuar atmosferë të mirë pune, përfshihen elementët përbërës:

- 1.1 Qëndrimi tolerant;
- 1.2 Mbështetja tek arritjet e të tjerëve;
- 1.3 Kërkesa e pjesëmarrjes pozitive;
- 1.4 Raportimi i rezultateve të punës;
- 1.5 Hapja ndaj shqetësimeve të kolegëve dhe punonjësve të tjerë.

NENI 41

AFTËSIA PËR TË KRIJUAR MARRËDHËNIE TË MIRA ME VARTËSIT

1. Në kriteret e aftësive për të krijuar marrëdhënie të mira me vartësit, përfshihen elementët përbërës:

- 1.1 vlerësimi i praktikës më të mirë në një zonë të caktuar ose një lloji të caktuar krimi apo çështjeje dhe ndarja e njohurive dhe eksperiencës me kolegët e tij;
- 1.2 Mbështetja e punës, udhëzimi dhe drejtimi i tyre nëpërmjet shembujve;
- 1.3 Krijimi i kushteve për një qëndrim korrekt të punonjësve;
- 1.4 Komunikimi, transmetimi i ndjenjës së barazisë në personel.

NENI 42

AFTËSIA PËR USHTRIMIN E FUNKSIONIT TË MBIKËQYRJES NË NJË MËNYRË TË PËRGJEGJSHME DHE TË KOMUNIKUESHME

1. Në kriteret e aftësive për ushtrimin e funksionit të mbikëqyrjes në një mënyrë të përgjegjshme dhe të komunikueshme, përfshihen elementët përbërës:

- 1.1 Caktimi i përshtatshëm i detyrave për personelin, duke u orientuar nga objektivat;
- 1.2 Shpjegimi i veprimeve dhe masave në një mënyrë bindëse dhe të kuptueshme;
- 1.3 Qenia si balancues, nxitja e solidaritetit, mbështetja e prokurorëve të rinj dhe punonjësve të tjerë;
- 1.4 Njohja e aktiviteteve kryesore dhe themelin e çështjes, planeve dhe drejtimi i punës respektivisht;
- 1.5 Përfaqësimi i zyrës, kontaktimi me autoritetet bashkëpunuese dhe partnerët e jashtëm;

NENI 43

VEÇORITË E PUNËS MBIKËQYRSE

1. Në veçantësitë e punës mbikëqyrëse, përfshihen disa element përbërës:

- 1.1 Mbikëqyrja tematike, për krimet serioze;

- 1.2 Planifikimi i punës për çështjet e procedimeve penale;
- 1.3 Procedurat e trajtimit të çështjeve;
- 1.4 Krahasimi i ngarkesave të ndryshme të punës, krahasuar me tregues të punës “normale”;
- 1.5 Puna për çështjet dhe afatet e procedimit në kategoritë e përzgjedhura të çështjeve;
- 1.6 Praktikat e arrestimit në flagrancë, ndalimit dhe afatet e paraburgimit, raportimet periodike (2 mujore) në gjykatë;
- 1.7 Zbatimi i masave dhe mjeteve të posacme hetimore;
- 1.8 Praktikat e ankimeve;
- 1.9 Raportet dhe trajtimi i tyre, brenda zyrës, si dhe në Prokurorinë e Përgjithshme.

SEKSIONI V

KRITERE TË VLERËSIMIT TË DISIPLINËS NË PUNË

NENI 44

VLERËSIMI I DISIPLINËS NË PUNË

Prokurori vlerësohet për respektimin e disiplinës në punë për përmbushje me besnikëri të disiplinës formale dhe të disiplinës së punës dhe angazhimeve profesionale, personale, morale dhe etike në ushtrimin e funksioneve në zbatim të Kushtetutës dhe ligjeve, duke ruajtur të pastër figurën e prokurorit.

SEKSIONI VI

KONSIDERIMI I MASËS DISIPLINORE NË KRITERET E VLERËSIMIT

NENI 45

MASA DISIPLINORE

1. Masa disiplinore ndaj prokurorit që do të konsiderohen në vlerësim janë “vërejtja”, “vërejtje me paralajmërim për shkarkim nga detyra” dhe “pezullimi nga detyra ose kalimi në një detyrë tjetër, më të ulët, brenda sistemit të prokurorisë”, të cilat janë në fuqi në kohën e vlerësimit të punës së tij.
2. Nëse është dhënë një masë disiplinore si pezullim nga detyra apo kalimi në një detyrë tjetër, më të ulët brenda sistemit të prokurorisë, duhet të bëhet një vlerësim me synimin e ri-integrimit, duke marrë parasysh njëkohësisht një vlerësim nga departamenti apo zyra ku prokurori ka punuar ose shërbyer në efektin e masës disiplinore. Shefi i departamentit ose zyrës përkatëse duhet të bëjnë vlerësim të punës së tij.

KREU III

BURIMET, AKTET DHE PROCEDURAT E VLERËSIMIT

NENI 46

AKTET PROCEDURALE PENALE TË MARRA NGA PROKURORIT

1. Për vlerësimin e prokurorit do të përdoren:
 - 1.1 Akte të procedimeve penale të marra nga prokurori, të përzgjedhura nga Drejtoria e Inspektimit dhe Burimeve Njerëzore;
 - 1.1.1 Akte të kryera nga prokurori në procedimet penale:
 - në hetimet paraprake,
 - në ngritjen, përfaqësimin dhe qëndrushmërinë e akuzave në gjykatë,
 - në ekzekutimin e vendimeve penale dhe mbikëqyrjen e vuajtjes së dënimit;
 - 1.1.2 Akte në lidhje me mbikëqyrjen, ndihmen apo udhëzimin e kolegëve të rinj;
 - 1.1.3 Akte për bashkëpunimin me policinë gjyqësore dhe menaxhimin e saj;
 - 1.1.4 Akte lidhur me sjelljen personale, aftësitë shoqërore, aftësitë teknike;
 - 1.1.5 Vërejtje të shkurtër në lidhje me shëndetin fizik dhe aftësinë për të punuar nën presion;
 - 1.2 Akte të procedimeve penale të marra nga prokurori, që prezantohen nga vetë ai;
 - 1.3 Akte të procedimeve penale të marra nga prokurori, të prishura ose të mospranuara nga gjykata apo të ndryshuara ose shfuqizuara nga prokurori më i lartë.

NENI 47

AKTI I VLERËSIMIT TË DREJTUESIT TË PROKURORISË

1. Drejtuesi i Prokurorisë, ku ushtron funksionin prokurori, bën vlerësimin e punës dhe të aftësive profesionale e morale të prokurorit në formën e një akti të shkruar, sipas formularit nr.1, pjesë përbërëse e këtij Sistemi. Ky vlerësim shërben si propozim për Prokurorin e Përgjithshëm.
2. Në këtë formular, drejtuesi i Prokurorisë përshkruan veprimtarinë e prokurorit, duke bërë një vlerësim të përgjithshëm, si dhe shprehet mbi secilin tregues dhe aftësi, si dhe mbi mangësitë profesionale dhe morale që janë të rëndësishme për një vlerësim të drejtë.
3. Vlerësimi i drejtuesit të Prokurorisë shoqërohet me treguesit statistikore për volum, cilësinë dhe shpejtësinë, sipas tabelës “Formulari statistikorë me tregues të punës së prokurorit...”, që është pjesë përbërëse e këtij Sistemi.
4. Vlerësimi i propozuar duhet ti paraqitet prokurorit që vlerësohet, për tu njohur dhe për t’u shprehur mbi të, nëse është dakort dhe ta nënshkruaj atë brenda 8(tetë) ditëve nga paraqitja e vlerësimit të propozuar. Pas kësaj, bashkë me një kundër deklaram të mundëshëm të prokurorit, ai i

paraqitet Prokurorit të Përgjithshëm, siç u përmend në pikën 1 të këtij neni.

5. Vlerësimi mund të përdoret për arsye statistikore, si dhe për aq sa treguesit në lidhje me punën e prokurorit mund të shërbejnë si bazë për statistikat e prokurorisë.

NENI 48

TRAJTIMI I VLERËSIMIT PARAPRAK

1. Prokurori i Përgjithshëm mund të zëvendësojë vlerësimin e propozuar nga drejtuesi i prokurorisë, krahasuar me vlerësimet në shkallë vendi, me një vlerësim mbikëqyrjeje të një niveli më të lartë, për qëllime të brendshme vlerësimi, duke marrë parasysh një kundër-deklarim të prokurorit. Drejtuesi i prokurorisë dhe prokurori informohen në lidhje me këtë fakt.

2. Në rastet e zbatimit, vlerësimi i paraqitet Këshillit të Prokurorisë për të marrë mendimin e tij në lidhje me vlerësimin e kandidatit, duke u zbatuar e njëjta procedurë që parashikon neni 47/4 i kësaj Rregullore

NENI 49

AKTI I VETËVLERËSIMIT TË PROKURORIT

1. Prokurori pasi njihet me vlerësimin paraprak të nënshkruar nga drejtuesi i prokurorisë, nëse nuk bie dakord me vlerësimin, ai ka të drejtë të bëjë një kundër-deklarim me shkrim ose një vetëvlerësim brenda 8(tetë) ditësh nga njohja me vlerësimin e propozuar. Kundërdeklarimi ose vetëvlerësimi duhet të jetë i arsyetuar dhe të përshkruajë veprimtarinë e tij, të bëjë një vlerësim të përgjithshëm, duke u shprehur mbi secilin tregues.

2. Nëse prokurori i Drejtorisë së Inspektimit dhe Burimeve Njerëzore të Prokurorisë së Përgjithshme bie dakord plotësisht ose pjesërisht me kundër deklarimin (ankesë) ia paraqet atë Këshillit të Prokurorisë, duke paraqitur mendimin se do të kryhet rishikimi i vlerësimit të kundërshtuar.

3. Nëse ai nuk bie dakord me ankesën, prokurori i Drejtorisë së Inspektimit dhe Burimeve Njerëzore të Prokurorisë së Përgjithshme e paraqet vlerësimin së bashku me mendimin e tij dhe ankesën e arsyetuar tek Këshilli i Prokurorisë që mund të vendosë nëse duhet rishikuar menjëherë apo rënë dakord me vlerësimin.

4. Nëse Këshilli i Prokurorisë refuzon ose vendos ta bëjë vlerësimin, Drejtoria e Inspektimit dhe Burimeve Njerëzore të Prokurorisë së Përgjithshme e respekton atë vendim.

5. Nëse një rishikim nuk duhet bërë, prokurori që bën ankimin duhet të informohet nëpërmjet një vendimi të arsyetuar nga Këshilli i Prokurorisë. Vendimi i Këshillit të Prokurorit duhet të mbahet në dosjen e personale të prokurorit.

Neni 50

AKTI I VLERËSIMIT PARAPRAK TË DREJTORISË SË INSPEKTIMIT DHE BURIMEVE NJERËZORE

1. Prokurori i Drejtorisë së Inspektimit dhe Burimeve Njerëzore në Prokurorinë e Përgjithshme, mbështetur në materjalet e inspektimeve, vlerësimin e drejtuesit të Prokurorisë, vetëvlerësimin e prokurorit dhe masat disiplinore të dhëna ndaj tij, bën vlerësimin e punës dhe të aftësive profesionale dhe morale të prokurorit në formën e një akti të shkruar, sipas formularit nr.1, pjesë përbërëse e këtij Sistemi, duke sugjeruar:

- 1.1 rishikimin në zbatim të nenit 47/4,2 të kësaj rregullore, nëse ai vlerëson dhe bën shënimin se do të rishikojë vlerësimin e kundërshtuar;
- 1.2 informimin e Këshillit të Prokurorisë, nëse vlerësimi i bërë nga drejtuesi i prokurorisë është i paplotë, nuk përmbush kërkesat e ligjore.

2. Në këtë formular prokurori i kësaj Drejtorie përshkruan aktivitetin e prokurorit, duke bërë një vlerësim të përgjithshëm, si dhe shprehet mbi secilin kriter dhe aftësi që duken të nevojshme për tu marrë në konsideratë për një vlerësim të saktë dhe tregon mangësitë profesionale, duke hartuar projektaktin paraprak të vlerësimit, formulari nr.1.

3. Nëse ky vlerësim është më i keq se i pari apo i ankimuar, prokurori ka të ka të drejtën e një interviste personale me Drejtorinë e Inspektimit dhe të Burimeve Njerëzore në Prokurorinë e Përgjithshme, ku diskutohen rezultate të ndryshme të vlerësimit të punës së këtij prokurori.

NENI 51

PROJEKTAKTI PËRFUNDIMTAR I VLERËSIMIT

1. Këshilli i Prokurorisë pasi shqyrton dosjen e vlerësimit të prokurorit përgatit projektaktin përfundimtar të vlerësimit, sipas formalurit nr.2, dhe mendimin e vet ia paraqet Prokurorit të Përgjithshëm.

2. Në projektaktin përfundimtar të vlerësimit të prokurorit Këshilli i Prokurorisë parashtron mendimin për vlerësimin e prokurorit, me një nga vlerësimet, si më poshtë:

- a. Shumë mirë
- b. Mirë
- c. Mjaftueshëm

- d. I paaftë.
3. Vlerësimi përfundimtar shumë mirë jepet kur prokurori në totalin e vlerësimeve ka marrë vlerësimin shumë mirë, në katër komponent, ku njëri detyrimisht duhet të jetë komponenti i aftësive profesionale.
 4. Vlerësimi i paaftë jepet kur prokurori është vlerësuar si i tillë, në komponentin e aftësive profesionale.
 5. Këto kritere vlejné për të gjithë subjektet që kryejné vlerësimin si dhe për të gjithë llojet e vlerësimit.

NENI 52
AKTI I VLERËSIMIT

Prokurori i Përgjithshëm, pasi shqyrton dosjen e vlerësimit të prokurorit dhe projektaktin përfundimtar të vlerësimit të Këshillit të Prokurorisë, vendos për vlerësimin përfundimtar.

NENI 53
E DREJTA E ANKIMIT

Projektakti përfundimtar i vlerësimit të Këshillit të Prokurorisë mund të ankimohet nga prokurori brenda 8 (tetë) ditëve nga dita e komunikimit, në Këshillin e Prokurorisë ose tek Prokurori i Përgjithshëm.

NENI 54
SHQYRTIMI I ANKIMIT

1. Në rast të një ankimi, Këshilli i Prokurorisë shqyrton dosjen e vlerësimit të prokurorit, që i vihet në dispozicion.
2. Këshilli i Prokurorisë dëgjon prokurorin, pas tij Drejtorin e Inspektimit dhe Burimeve Njerëzore, me të drejtën për t'u bërë pyetje dhe vendosë për pranimin ose mospranimin e korigjimit të projektaktit përfundimtar të vlerësimit të punës së tij, duke iu kthyer përgjigje me shkrim prokurorit të interesuar.

NENI 55
HYRJA NE FUQI DHE EFEKTI VEPRUES

1. Kjo Rregullore hyn në fuqi menjëherë.
2. Me këtë rregullore të njihen të gjithë prokurorët.